USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Bëhu pjesë e iniciativës

SË BASHKU PËR TË RINJTË

Iniciativa "Së Bashku për të Rinjtë" në Han të Elezit mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes aktivitetit Up to Youth.

Up to Youth është aktivitet pesë vjeçar i përkushtuar që të përmirësojë kapacitetet e rinisë dhe të krijojë mundësi për aspiratat e rinisë, në mënyrë që ata të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga komunitete më të qëndrueshme, më demokratike dhe më prosperuese.

Kush jemi ne?

Jemi të rinjtë vullnetarë të Hanit të Elezit.

Çfarë aspirojmë?

Qëllimi jonë është përfshirja e të rinjve nga Hani i Elezit dhe fshatrave të kësaj komune në aktivitetet rinore përmes anëtarësimit në forum ku do të informohen rreth programeve dhe aktiviteteve aktuale. Do të punojmë së bashku për të ofruar ide, mendime dhe për të ngritur zërin në çështje të ndryshme që e preokupojnë rininë e komunës së Hanit të Elezit.



Pse vullnetarizmi është i rëndësishëm për komunën tonë?

Vullnetarizmi është mundësi për t'u bërë anëtar aktiv në komunitetin tënd dhe për të rritur përgjegjësinë qytetare. Angazhimi yt fuqizon pjesëmarrjen qytetare dhe vendim-marrjen në çështjet që ndikojnë në jetën e përditshme në komunitet. Kontribuoni në zhvillimin e kulturës së reciprocitetit dhe të solidaritetit, në adresim të problemeve të rinisë për një cilësi më të mirë të jetesës.

Çka përfitoni?

I forconi lidhjet tuaja me komunitetin dhe zgjeroni rrjetin tuaj social duke u shoqëruar me njerëz që kanë interesa të përbashkëta. Informoheni me kohë për mundësitë e ndryshme ku ju si të rinj të Hanit të Elezit mund të merrni pjesë, të angazhoheni dhe aftësoheni përmes trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme.

Bëhu pjesë e iniciativës

SË BASHKU PËR TË RINJTË

Skanoni këtë QR code që të bëheni pjesë e grupit virtual të iniciativës, ku mund të merrni informata më të hollësishme për vullnetarizmin në komunitet.

Iniciativa "Së Bashku për të Rinjtë" është mundësuar nga mbështetja bujare e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Global Communities dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.